

ASEDA BEHARI

VËSHTRIM SINTAKSOR I GJUHËS SË E. KOLIQIT NË PROZËN
HIJA E MALEVE

“Nuk janë shum shkrimtarët t’onë, emni i të cilvet të njifët aq mirë në shtresat letrare shqipe sá ai i Koliqit; të pakët janë atá, prodhimet e të cilvet të kenë marrë aq hapt në çdo kând të Shqipnís, sá ato qi emnin e tij në çfaqje kulturore gjithëfarësh, në botime nëpër fletore e revista të ndryshme, disá prej të cilavet themelue dhe mbajt prej tij vetë, në botime veprash qi janë të pacaktueme të zánë një vend të dukshëm, dashtas e padashtas, në historín e letrave t’ona.”¹

Ernest Koliqi, pseudonimi i themeluesit të prozës moderne shqiptare, lindi më 20 maj 1903 në Shkodër. Ai ishte poet, tregimtar, novelist, romancier, dramaturg, kritik, studiues dhe publicist i njohur i letrave shqipe.

Në këtë punim do të trajtohet në rrafshin sintaksor një ndër prozat më të njohura të tij, proza “Hija e maleve”. Kjo prozë, në vetvete e përbërë nga “Nusja e mrekullueshme”, “Gjaku”, “Kânga e re”, “Se qofsh, pleqnofsh”, “Kërcimtarja e Dukagjinit”, “Miku”, “Ândërr e një mbasditje vere”, “Kur orët lajmojnë”, “Kopshti”, “Ke tre lisat”, “Diloca” dhe “Zâna e fundme”; përbën një trashëgimi të vërtetë letrare, që ka ardhur në variantin më të përparuar shkrimor të gegërishtes.

Në këtë prozë fjalitë njëkryegjymtyrëshe gjejnë një përdorim më të paktë, kurse ato dykryegjymtyrëshe gjejnë një përdorim më të dendur.

Ndër fjalitë njëkryegjymtyrëshe mbizotërojnë ato foljore, krahasuar me ato emërore, si në rastet: *Shtiu!* (2/Nmb. f. 9), *Ndëgjo.* (2/Ktl. f. 132), *Ishin kushrîj e miq.* (2/Zfu. f. 158) etj.

Nga fjalitë dykryegjymtyrëshe do të bëjmë objekt studimi të këtij punimi ndërtimet e frazave asindete dhe sindete me bashkime me hipotaksë, sipas grupeve të mëposhtme:

1. Ndërtimi i frazave asindete dhe sindete me bashkime me hipotaksë

1.1. Me marrëdhënie ftilluese (Gr.I):

1.1.2. Me marrëdhënie subjektore (kryefjalore)²

Periudhë me fjali të varur kryefjalore quhet ajo periudhë me një fjali të varur që kryen ndaj fjalisë kryesore një funksion të ngjashëm me atë të një kryefjale të një fjalie dykryegjymtyrëshe.

Pjesët lidhen ndërmjet tyre me anë të lidhëzave *se, që, sikur, tek, kur* ose drejtpërdrejt, kur kallëzuesi i pjesës së nënrenditur është një folje në mënyrën lidhore.³

¹ K. Gurakuqi, *Shêjzat*, Vj. VII, 1963, nr. 5-8, f. 163.

² Paraqitjen strukturore skematike, e kemi bërë në përngjasim të tekstit universitar të gjuhëtarit Mehmet Çeliku “*Sintaksë e gjuhës shqipe*” (*Përbërësit sintaksorë*)- Vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë, 2012, Kreu V, Fjalitë e përbëra (Periudhat), f. 333-349.

Le të marrim në shqyrtim frazën e mëposhtme:

Dihet prej gjithkuj / se sa mâ shum vjet të rrijë njeriu larg vëndeve / që qenë shkena e lojname fëmijërore / aqë mâ tepër këto rrethohen me avullin e ândrrave / e aqë mâ i madh bâhet dëshiri me i pá. (2/Kop., 113)

Këtu ndërtimi i frazës është i drejtë, sepse nis me fjalinë drejtuese (*Dihet prej gjithkuj...*), pastaj vijohet me njësitë e tjera. Njësia e dytë e varur lidhet me njësinë drejtuese me anë të lidhëzës nënrenditëse filluese *se*.


Në këtë prozë, ashtu si edhe në të tjerat, këto marrëdhënie shfaqen jo rrallë. Le të marrim në shqyrtim rastin e një proze tjetër të Koliqit:

Por i ra në mend / se mjerisht s'ishte mâ kalamâ, / e se duhej disi spjegue pranija e tij n'at vënd të huej. (2/Kpl. 246)


Këtu ndërtimi i frazës është i drejtë, sepse nis me fjalinë drejtuese (*I ra në mend...*), e vetmja QOS (qendër e organizimit sintaksor), dhe vijon me njësitë e nënrenditura homogjene me njëra-tjetrën (*...mjerisht s'ishte më kalama dhe duhej disi spjegue pranija e tij n'at vënd të huej*). Kjo është një frazë sindete me marrëdhënie kryefjalore. Njësitë e varura lidhen me njësinë drejtuese me anë të lidhëzës nënrenditëse filluese *se*. Fjalja e dytë e varur “...duhej disi spjegue pranija e tij n'at vënd të huej” ka në përbërjen e saj një kallëzues të përbërë foljor: *duhej (disi) spjegue*. Kallëzuesi i përbërë foljor formohet nga dy fjalë kuptimplote nga të cilat e para tregon një mënyrë veprimi (fillim, vazhdim, mbarim, përforsim, rritje progresive të veprimit) ose modalitet (domosdoshmëri, supozim, mundësi etj.), kurse e dyta shpreh një veprim.⁴ Siç e dimë, këto njësi janë të pandërmjetuara (immediate). Te Koliqi vërejmë që janë të ndërmjetuara. Si në rastin e mësipërm: ...duhej disi spjegue...

Paraqitja skematike për këtë fjali do të jetë:

a)



Kurse për fjalinë e parë do të kishim këtë paraqitje skematike:



³ Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa, ASHRSH, Tiranë, 2002, Kreu XXII, f. 503.

⁴ Po aty, f. 183.

1.1.3. Kallëzuesore

Periudhë me fjali të varur kallëzuesore quhet periudha me një fjali të varur që kryen funksionin e pjesës emërore të kallëzuesit emëror ose funksionin e përcaktorit kallëzuesor.⁵

Fjalitë e varur kallëzuesore bashkohet me pjesën kryesore me lidhëzat, *se*, *që*, *sikur*, *kur*, *tek* ose drejtpërdrejt kur kallëzuesin e ka në mënyrën lidhore, me përemra të pacaktuar, me përemra lidhorë dhe me ndajfolje lidhore.⁶

Shfaqjet e këtyre marrëdhënieve, që po i japim në mënyrë të shkurtuar me vjershën për fëmijë “Mendelehti”, janë të rralla në këtë prozë: *Ai që vetëm beson / shka shet / e i thonë, / Mendjelehtë do thirrë gjithmonë; / Ai që kurgja s’beson pa prekë, pa ndi, / Edhe ai ndër t’ marrë do shti.* / (2/Mendelehti, f. 59)⁷

1.1.4. kundrinore (objektore)

Periudha me fjali të varur kundrinore, quhet periudha me një fjali të varur që drejtpërdrejt ose tërthorazi kryen një funksion të ngjashëm me atë të një kundrine (të drejtë, të zhdrejtë me parafjalë ose të zhdrejtë pa parafjalë).⁸


Ndërtime të tilla janë mjaft të dendura në prozën e Koliqit, që dalin me mjete të shumta të lidhjes sintaksore (m.l.s.): jo vetëm me lidhëzat filluese “*që*”, “*se*”, por edhe me përemra pyetës lidhorë, pa mjete lidhëze, etj.

Mund të shënojmë se për lidhjen e fjalive të varura kundrinore e kryefjalore, ndër lidhëzat filluese, përdoret më dendur lidhëza “*se*”, në krahasim me lidhëzën tjetër, të zëvendësueshme prej saj “*që*”.

Në krijimtarinë e Koliqit nuk janë të rralla rastet kur gjejmë trajta të paskajores dhe përcjellores, që marrin vlerë kallëzuesore; midis tyre dalin pak më dendur marrëdhëniet kundrinore.

Këtë do ta bëjmë në pajtim me rregullin (marrëveshje gjuhëtarësh) të vendosur në Gramatikën tonë normative.⁹

- a) *A din / me më kallzue gjâ për një vajzë të vogël / qi i thojsin Dushë / edhe rrinte me shtëpi këndeji pari diku?* (2/Kop., f. 121)



⁵ Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa, ASHRSH, Tiranë, 2002, Kreu XXII, f. 511.


⁶ Po aty.

⁷ M. Çeliku, Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë), Ilar, Tiranë, 2012, f. 363.


⁸ Po aty, f. 515.

⁹ Gramatika e gjuhës shqipe, II, ASHRSH, IGJL, Tiranë, 1996, f. 547.

- b) *Të kam thënë njëqind herë / se duhet rrejtë. (2/Ktl. 123)*



- c) *Kam pas kujtue / se Malsoret janë më trimnesha. (2/Dil., 143)*



- d) *S'qeshë i zoti// ta ndaloj hovin e zëmrës. (2/Dil. 137)*

Gjymtyrëzimi aktual dallon në shumicën e rasteve dy pjesë përbërëse: atë për të cilën bëhet kuptimi (tema) dhe atë që kumtohet për temën (rema)¹⁰. Vërehet përdorimi i zhdrejtë (kallëzues+ kryefjalë) i përdorur më shpesh në frazat me marrëdhënie kundrinore.

1.2. Me marrëdhënie përcaktore (Gr.II)

Periudhë me fjali të varur përcaktore quhet ajo periudhë në të cilën fjalia e varur tregon në përgjithësi një karakteristikë të një sendi të shprehur prej një gjymtyre emërore, të shprehur rëndom me emër ose me përemër, zakonisht vetor, i cili është paraprijësi i saj.¹¹

Ndërtimi i frazave me marrëdhënie përcaktore është përdorur më dendur prej Koliqit. Le të marrim në shqyrtim frazën:


- a) *Djelmoshat, me kapuçë të leshët në krye, kapën mauzerret, / qi sa ngjati mesha kishin ndëjë të varuna tu dera e kishës, / e kaluen teposhtë kah logu i shëjit. (2/Nmb., 9)*

Këtu ndërtimi i frazës është i drejtë, sepse nis me fjalinë drejtuese dhe vijon me njësinë e nënrenditur. Kjo është një frazë sindete me marrëdhënie përcaktore.

Njësia e nënrenditur “...qi sa ngjati mesha kishin ndëjë të varuna tu dera e kishës”, varet nga fjala mauzerret dhe kryen një funksion të ngjashëm me atë të përcaktorit në fjalinë e thjeshtë. Pra, fjalia drejtuese (*Djelmoshat, me kapuçë të leshët në krye, kapën mauzerret*) ka në varësi një përbërës predikativ përcaktor, të lidhur me përemrin lidhor “që” (edhe me funksionin kryefjalë “të cilat”) dhe ka rend të paravendosur.


¹⁰ Po aty, f. 414.

¹¹ Po aty, f. 525.




Paraqitjet skematike të disa fjalive të tjera:


b) *Shtegu / qi çon te kroni / â shetija e katundareve.* (2/Ktl. 127)




c) *Kush të ka mësue me i rá pjanofortës?* (2/Anjmv. 102)



d) *S'kishte shkodran / qi mos t'a njihte Ton Laskun.* (2/Kre. 55)



e) *Ajo ferrë, që i ishte ngulë në zëmër, s'e lente me mbyllë sy natën.*
(2/ Sqp.70)



1.3. Me marrëdhënie rrethanore (Gr.III)


1.3.1. Shkakore

Periudhë me fjali të varur shkakore quhet ajo periudhë që shpreh marrëdhënie shkak-pasojë, tregon shkakun ose arsyen e asaj që thuhet në fjalinë drejtuese, d.m.th vë në dukje lidhjen shkakore midis fjalive.¹²

Në këtë prozë, ashtu si edhe në gjithë prozën e Koliqit, vërehen disa raste të këtyre marrëdhënies, që kryesisht ndërtohen me lidhëzat e njohura, por edhe me disa të quajtura polisemantike, emërtuar ndryshe joshkakore, por që tregojnë marrëdhënie shkakut e pasojë.

Le të shohim modelin e marrë në shqyrtim, bashkë me paraqitjet e tij strukturore skematike:

a) *Kjo, ndoshta, â mâ mirë për to, / sepse kânga e kronit shëndrrohet në vajë, tue jehue në thellsit e shpirtit.* (2/Ktl. 128)



1.3.2. Qëllimore

Periudhë me fjali të varur qëllimore është ajo periudhë në të cilën fjalia e varur tregon qëllimin për të cilin kryhet veprimi i shprehur në fjalinë drejtuese, atë që synohet të arrihet nëpërmjet këtij veprimi.¹³

Këto lloje marrëdhënies vërehen rrallë, duke qenë kryesisht të shprehura me njësi predikative me formën e pashtjelluar paskajore geqe me “me”; natyrisht, në strukturën e frazës, marrëdhëniet nënrenditëse qëllimore nuk mund të jenë të vetme, po të ndërthurura me të tjera.

Fjalia e varur qëllimore i referohet zakonisht gjithë fjalisë prej së cilës varet. Ajo lidhet me të me lidhëzën *që*, me lokucionet lidhëzore *me qëllim që, në mënyrë që* ose bashkohet me të drejtpërdrejtë¹⁴, si në shembullin e mëposhtëm:
E ndihmova / m’u çue, / me gjith që pata pak zor ta preki. (2/Dil., 138)



1.3.3 Kohore

Periudhë me fjali të varur kohore quhet periudha me nënrenditje ku fjalia e varur tregon kohën kur ndodh veprimi, ngjarja e fjalisë kryesore.¹⁵

¹² Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa, ASHRSH, Tiranë, 2002, Kreu XXXIII, f. 564.


¹³ Po aty, f. 555.

¹⁴ Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa, ASHRSH, Tiranë, 2002, Kreu XXXIII, f. 555.


¹⁵ Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa, ASHRSH, Tiranë, 2002, Kreu XXXIII, f. 544.

Frazat me marrëdhënie kohore gjejnë një përdorim mjaft të dendur. Jo rrallë në prozën e Koliqit marrëdhëniet kohore ndërtohen jo vetëm me lidhëzat e njohura kohore, por edhe me mjete të tjera, si me ndajfoljen “kah/nga” në trajtën dialektore. Rendi më i zakonshëm është ai me paravendosje dhe me ndërvendosje.


a) *Edhe Toni, si shumica e Shqiptarvet, / kur u pá i kapërthyem në këtë ndiesí t'âmbël e t'idhët përnjiherë, / u ndry në vetvete e s'i bâni zâ kuj.* (2/KngRe., 59)



b) *Mbasi çela derën e oborrit, / u kujtova se kisha harrue çelsin e derës së shtëpís.* (2/Dil. 142)




c) *Don Marku pështeti shpinën për karrikë, / mbasi piu një hurm vënë, / e i a nisi.* (2/Nmb.12)



1.3.4 Mënyrore

Periudhë me fjali të varur mënyrore është ajo periudhë në të cilën fjalia e varur tregon mënyrën e kryerjes së një veprimi a të paraqitjes së një fakti të shprehur në fjalinë nga e cila varet.¹⁶

Sikurse do t'a keni ndëgjue sa herë e herë, / vëndi i ynë motit ishte an'e kând i populluem me Zâna kângatаре. (2/ Zfu., 159)




¹⁶ Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa, ASHRSH, Tiranë, 2002, Kreu XXXIII, f. 551.

1.3.5 Lejore

Periudhë me fjali të varur lejore quhet ajo periudhë në të cilën fjalia e varur shpreh një veprim a gjendje që pritet të pengojë realizimin e veprimit të fjalisë drejtuese, por që nuk arrin ta ndalojë atë.¹⁷


Me gjithë qi pardje i bërtita, prap sot të veten se të veten: / ka lânë mbas porte mâ se pesë minuta Loron, kolegun t'em. (2/Dil., 141)



1.3.6 Krahasure

Periudhë me fjali të varur krahasore quhet ajo periudhë në të cilën veprimi a gjendja për të cilën bëhet fjalë në fjalinë drejtuese karakterizohet me anë të një krahasimi me një veprim a gjendje të shprehur në fjalinë e varur.¹⁸

a) *A ka send mâ të mrekullueshëm në këtë botë / se me i sjellë qytetnimitin një kombi zhytë n'errsin e padijes?* (2/ Gjak. 18)



KONKLUSIONE

Proza “Hija e maleve”, ashtu si edhe krijimtaria tjetër e Ernest Koliqit ka ardhur në variantin shkrimor më të përparuar të gegërishtes. Në këtë prozë, në planin sintaksor, janë vërejtur ndërtime të shumta të lidhjes sintaksore (m.l.s.): jo vetëm me lidhëzat përkatëse të shprehjes së marrëdhënieve, por edhe me përemra pyetës lidhorë, pa mjete lidhëze, me ndajfoljen “kah/nga” në trajtën dialektore etj. Po ashtu, nuk janë të rralla rastet kur gjejmë trajta të paskajores dhe përcjellores, që marrin vlerë kallëzuesore; midis tyre dalin pak më dendur frazat me marrëdhënie kundrinore, të cilat i kemi marrë të tilla (me vlerë kallëzuesore) në pajtim me rregullin (marrëveshje gjuhëtarësh) të vendosur në Gramatikën tonë normative.¹⁹

Kryesisht ndërtimet e frazave janë të drejta, sepse nisin me fjalitë drejtuese dhe vijojnë me njësitë e nënrenditura.

Sa i përket klasifikimit të fjalive sipas gjymtyrëve kryesore, vërehet që fjalitë njëkryegjymtyrëshe gjejnë një përdorim më të paktë në këtë prozë, kurse ato

¹⁷ Po aty, f. 596.

¹⁸ Po aty, f. 605.

¹⁹ Gramatika e gjuhës shqipe, II, ASHRSH, IGJL, Tiranë, 1996, f. 547.

Vështrim sintaksor i gjuhës së E. Koliqit në prozën *Hija e maleve*

dykryegjymtyrëshe gjejnë një përdorim më të dendur. Ndër fjalitë njëkryegjymtyrëshe mbizotërojnë ato foljore krahasuar me ato emërore.

Frazat me përbërës predikativë përcaktorë janë frazat që ndeshen më shpesh, kurse ato me përbërës predikativë kallëzuesorë ndeshen shumë rrallë.

Tabela e shkurtimeve:

- Fr	Fraza (periudha)
- Fjdr/Fkr	Fjali drejtuese / Fjali kryesore
- QOS	Qendër e organizmit sintaksor
- Fjvkr	Fjali e varur kryefjalore
- Fjvp	Fjali e varur përcaktore
- Fjvq	Fjali e varur qëllimore
- Fjvshk	Fjali e varur shkakore
- Fjvko	Fjali e varur kohore
- Fjvv	Fjali e varur vendore
- Fjvkh	Fjali e varur krahasore
- Fjvmn	Fjali e varur mënyrore
- m.l.s.	Mjet i lidhjes sintaksore
- 2/Ktl.	Ke tre lista
-2/Dil.	Diloca
-2/KngRe	Kânga e re
- 2/Zfu.	Zâna e fundme

Shënim.

Numri përpara shënon vëllimin e veprës, kurse numri brenda punimit, shënon numrin e faqes ku gjenden shembujt e marrë.

BIBLIOGRAFI

- E. Koliqi, *Vepra 2*, Prishtinë, 2003.
Gramatika e gjuhës shqipe, II, ASHRSH, IGJL, Tiranë, 1996.
Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa, ASHRSH, Tiranë, 2002.
K. Gurakuqi, *Shënjat*, Vj. VII, 1963, nr. 5-8.
M. Çeliku, *Sintaksa e gjuhës shqipe-Përbërësit sintaksorë*, Tiranë, 2012.
T. Kelmendi, *Funksionet sintaksore të paskajores shqipe* (Redaktorë shkencorë: T. Topalli, E. Lafe, E. Kabashi), Prishtinë, 2010.

